

VENDIM
Nr. 499, datë 1.8.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 432, DATË 13.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE, TRAJTIMIN ME PAGË DHE
SHTESA MBI PAGË PËR PUNONJËSIT NË SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHETIT”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 22 të ligjit nr. 9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 432, datë 13.7.2007 të Këshillit të Ministrave, lidhja nr. 2 “Struktura dhe nivelet e pagave, sipas klasifikimit të funksioneve, për punonjësit në Shërbimin Informativ të Shtetit”, zëvendësohet me lidhjen më të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2012.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha